



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/37
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen procesverbalet nga mbledhjet 33 dhe 34 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/37


Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Plani i veprimit.
2. Obligohet Agjencia Kundër Korrupsionit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/37
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Koncept Dokumenti për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/37

Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Lulzim Syla, Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut, i vazhdohet mandati edhe për 3 (tre) vjet.
2. Z. Syla kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/37
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2018-2022 dhe Plani i veprimit.
2. Koordinator Nacional për Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë caktohet Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegojë tek njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha institucionet tjera kompetente.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/37
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 44 të Ligjit nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2018-2020.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimi Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/37
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 659 të datës 08.03.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për pagesën e paradhënies në vlerë prej tridhjetë përqind (30%) të vlerës së kontratës për projektin kapital, sipas kërkesës së datës 08 mars 2018.
2. Obligohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/37

Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për kryerjen e punëve përgatitore të parapara me nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, me qëllim të përgatitjes së kërkesës për shpronësim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për shpronësim të Objektivit të Shtëpisë së Sportit dhe ngastrave kadastrale; 6357-0; 6358-0; 6359-0; 6360-0; 6361-0; 6362-1; 6362-2; 6363-2; 6364 dhe 6363-1, parcela në të cilat gjendet ky objekt.
2. I autorizuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa të ndryshme para organeve kompetente dhe pranimin e dokumenteve që lidhen me qëllimin për të cilin është dhënë ky autorizim.
3. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të përgatisë dokumentacionin e përcaktuar me ligj dhe dokumentacionin me elaborat gjeodezik sipas normave të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/37

Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Integritimit Evropian, për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënie e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënie e autorizimit Ministres së Integritimit Evropian për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/37


Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes financiare IPA 2017, pjesa e dytë, me Bashkimin Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të Marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/37
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Koncept Dokumenti për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besueshme në lidhje me Transaksionet Elektronike.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/37

Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes për Sigurimet Sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/37


Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për kompensimin e shtesave dhe stimulim financiar të stafit administrativ për vitin 2018, në shumë prej 59,976,00 euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi janë të planifikuara në ndarjet buxhetore të vitit 2018 në organizatën buxhetore Këshilli Prokurorial i Kosovës me kod 250, nën programi Prokurorët Special me kod 32200, kategoria e shpenzimeve e Pagave dhe Mëditjeve.
3. Obligohet Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë